



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

R A P O R T

Për dekretin e Presidentit të Republikës, nr.8566, datë 16.05.2014
“Për kthimin e ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9049,
datë10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të
zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

1.0 HYRJE

Komisioni i Ligjeve, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 20 maj 2014, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës, nr.8566, datë 16.05.2014, “Për kthimin e ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9049, date 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Komisioni i Ligjeve e shqyrton këtë projektligj në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Komisioni caktoi relatore deputeten Vasilika Hysi.

Për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të dekretit, komisioni ftoi përfaqësues nga Presidenca, por në mbledhjen e Komisionit nuk u paraqit asnjë funksionar nga ky institucion.

2.0 ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Me Dekretin nr.8566, datë 16.05.2014, Presidenti i Republikës vendosi kthimin e ligjit nr.45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9049, date 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Nisur nga përmbajtja e materialit shpjegues të Dekretit të Presidentit të Republikës, rezulton se arsyet për kthimin e ligjit janë si më poshtë vijon:

- a) Neni 92 i Kushtetutës nuk parashikon në mënyrë shteruese kompetencat e Presidentit të Republikës, por parashikon disa kompetenca të cilat nuk janë përfshirë në kapituj të tjerë të Kushtetutës.
- b) Është e vërtetë që kompetenca që i është dhënë Presidentit të Republikës lidhur me propozimin e dy kandidaturave për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të

ILDKPKI-së nuk përfshihet në listën e kompetencave të cituara në nenin 92 të Kushtetutës dhe as në nene të tjera të saj, pasi ky Institucion nuk ishte krijuar në kohën e hartimit të Kushtetutës dhe ajo nuk mund të shprehej për institucione ose situata juridike që do të krijoheshin në të ardhmen.

- c) Neni 94 i Kushtetutës ka të bëjë me parimin e ligjshmërisë duke përcaktuar se Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të pabazuara në ligj apo që janë të papajtueshme me Kushtetutën.
- d) Është pikërisht neni 94 i Kushtetutës i cili shpreh qartë frymën e saj dhe qëllimin e kushtetutë-bërësve për t'i mundësuar ligjvënësit një lloj fleksibiliteti në përcaktimin e kompetencave të tjera për Presidentin për çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e marrëdhënieve ndërmjet organeve shtetërore ose institucioneve të krijuara me ligje të veçanta dhe që janë në pajtim me Kushtetutën (rasti i ILDKPKI).
- e) Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”*, të ndryshuar, është në përputhje të plotë me kushtetutën dhe ndryshimi i tij, si i çdo ligji tjetër, duhet të arsyetohet dhe justifikohet. Në rastin konkret përveç mungesës së arsyetimit nuk kemi të bëjmë as me një ndryshim të realitetit ligjor për çështjet në diskutim.
- f) Argumentet e dhënë në relacionin shoqëruar të projekt-ligjit, i miratuar nga Kuvendi, lidhur me ndryshimet e bëra në mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve nuk qëndrojnë, madje ka përpjekje për të interpretuar dispozitat kushtetuese në kundërshtim me qëllimin e tyre.
- g) Referimi në vendimin nr.212/2002 të Gjykatës Kushtetuese është i gabuar dhe është nxjerrë jashtë kontekstit për të cilin është shprehur Gjykata, e cila i referohet një institucioni kushtetues dhe konkretisht Kontrollit të Lartë të Shtetit duke argumentuar se *“përderisa Kushtetuta ka trajtuar organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve dhe statusin e drejtuesve të tyre, ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kufijtë e të drejtave të tyre”*.
- h) Kryerja e të gjithë procedurës, që nga propozimi i kandidaturave deri tek përzgjedhja e Inspektorit të Përgjithshëm nga i njëjti organ do të minimizojë pavarësinë e Institucionit që ai përfaqëson.
- i) Mundësia për përzgjedhjen e një kandidature politike në këtë funksion është shumë e madhe duke ditur se Kuvendi ka një shumicë politike të caktuar që dikton edhe përbërjen e Qeverisë.
- j) Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së drejton një institucion që merret me deklarin dhe kontrollin e pasurisë, legjitimitetin e burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta dhe procedura e re e përzgjedhjes shton konfliktin e interesit që do ketë organi propozues/përzgjedhës i kandidaturave.
- k) Procedura e emërimit nëpërmjet dy institucioneve, ku njëri propozon kandidaturat dhe tjetri emëron është një garanci për pavarësinë e ILDKPKI-së. Ky qëndrim mbështetet edhe nga Gjykata Kushtetuese e RSH-së me vendimin nr.2, të datës 19.01.2005, e cila e cilëson procesin e bashkëveprimit institucional midis Presidentit dhe Kuvendit në

përzgjedhjen e disa funksionarëve, si pjesë e balancimit midis pushteteve në përputhje me nenin 7 të Kushtetutës.

3.0. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

- 1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
- 2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

3.2 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen në fjalë:

Vendimi nr. 212/2002, nr. 29/2005, nr.14/2006, 14/2009, nr.22/2010, nr.41/2012 i Gjykatës Kushtetuese;

3.3 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

- 1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.*
- 2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.*

4.0 SHQYRTIMI I ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT

Presidenti e ka mbështetur argumentin e tij për kthimin e ligjit, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 94 të Kushtetutës, duke e interpretuar atë bazuar në tërësinë e kompetencave kushtetuese që i njihen nga neni 92 i Kushtetutës dhe dispozita të tjera të veçanta të tekstit kushtetues.

Sikurse është pasqyruar në raportin shoqërues të ligjit nr.45/2014, Komisioni i Ligjeve vlerëson se përmbajtja e dispozitës së neni 94 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është mjaft e qartë në lidhje me natyrën shteruese të kompetencave që Presidenti i Republikës ushtron brenda funksionieve që ai kryen në një republikë parlamentare.

Bazuar pikërisht në interpretimin e kësaj dispozite, propozuesit e iniciativës ligjvënëse, Komisioni i Ligjeve dhe vetë Kuvendi i Shqipërisë arritën në përfundimin se kompetenca që i është njohur Presidentit të Republikës në propozimin e kandidaturave për Inspektor të Lartë të ILDKPKI, nuk është e parashikuar në Kushtetutë.

Në rastin konkret, në interpretimin e nenit 94 të Kushtetutës, Kuvendi i Shqipërisë nuk kryen një artificë procedurale dhe as aktualizon një qëndrim me insinuata politike, por ushtron një funksion institucional, që i është njohur shprehimisht nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në vendimin e saj nr. 41/2012.

Kuvendi në një interpretim origjinal literal dhe teleologjik/qëllimor që i bën nenit 94, me miratimin e ligjit nr.45/2014, duke ndryshuar procedurën e përzgjedhjes së Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI ka shprehur vlerësimin dhe vullnetin e tij se kjo dispozitë kushtetuese, e shprehur në terma mohuese dhe përjashtimore, nuk ka pasur dhe nuk ka për qëllim që ligje të veçanta t'i njohin, japin dhe t'i lejojnë Presidentit të Republikës ushtrimin e kompetencave të tjera, tej atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë.

Ky standard është vendosur edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, në vendimin nr.212/2002, Gjykata Kushtetuese shprehet se: *“Për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji”*.

Komisioni i Ligjeve e gjen të pabazuar argumentin e përdorur nga Presidenti i Republikës për kthimin e ligjit nr.45/2014 se citimi i vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese është i gabuar dhe i nxjerrë jashtë kontekstit, duke pretenduar se në atë vendim ka gjetur interpretim norma kushtetuese që rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të një tjetër organi kushtetues, siç është Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Pikërisht ky argument, duhet të kishte shtyrë Institucionit e Presidentit të Republikës për të ardhur në një përfundim të kundërt nga ai që parashtrohet në arsyetimin e përcjellë së bashku me dekretin për kthimin e ligjit.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese përbëjnë jurisprudencën kushtetuese. Fuqia detyruese e këtyre vendimeve nuk kushtëzohet nga konflikti i individualizuar në subjekte konkrete në përfundim të të cilit nxirret vendimi përkatës.

Fuqia detyruese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, lidhet me interpretimin që kjo gjykatë i bën Kushtetutës, në cilësinë e garantit të Kushtetutës. Interpretimi i Gjykatës Kushtetuese shtrin efektet e tij edhe në argumentet që përdoret nga ana e Gjykatës, argumente që eventualisht gjejnë materializim edhe në raste të ngjashme.

Në vendimin e saj nr.14/2009, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është shprehur se: *“Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (Shih vendimin nr.5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Asnjë organ tjetër me përjashtim të vetë Gjykatës (dhe kjo lidhet me ndryshimin e praktikës, apo rishikimin e Kushtetutës), nuk mund të mos pranojë t'i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Roli i Gjykatës qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton autoritetin e këtij organi dhe është e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese.”*

Sigurisht, që interpretimi i kufijve që Kushtetuta i ka vendosur institucioneve kushtetuese në ushtrimin e kompetencave të tyre, në pajtim me të, sikundër është Kontrolli i Lartë i Shtetit, për më tepër Presidenti i Republikës, **është një çështje me natyrë kushtetuese.**

Nuk është i drejtë pretendimi i parashtruar në arsyetimet e Dekretit të Presidentit se interpretimi dhe argumenti që Gjykata Kushtetuese ka parashtruar në vendimin e saj nr.212/2002 nuk i shtrin efektet e saj në çështje të një karakteri të njëjtë, sikundër është arsyetimi i përdorur nga Kuvendi i Shqipërisë, përse i takon kufijve që Kushtetuta ka parashikuar në ushtrimin e funksioneve nga Presidenti i Republikës.

E kundërta e këtij konstatimi, do të vinte ndesh me arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në të njëjtin vendim nr.14/2009 ku në lidhje me fuqinë detyruese të vendimeve të kësaj gjykate sanksionohet se: *“Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj buron nga autoriteti i saj për të thënë fjalën e fundit në çështjet, për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata thekson se efekti detyrues shtrihet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj që përbëjnë edhe ratio decidendi....”.*

Raporti parlamentar për miratimin e ligjit nr.45/2009 është arsyetuar duke referuar qëndrimin e mbajtur në vendimin nr.212/2002 të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim është bërë burim i jurisprudencës kushtetuese edhe në disa vendimmarrje të tjera të kësaj Gjykate si vendimi nr.29/2005 dhe nr.14/2006.

Përse nënvizohet më lart, referimi që Kuvendi i Shqipërisë ka bërë në vendimin nr.212/2002 të Gjykatës Kushtetuese, për interpretimin e dispozitës së nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në çështjen e reformimit të procedurës së përzgjedhjes së Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, është krejtësisht i ligjshëm dhe i bazuar në doktrinën kushtetuese.

Neni 94 i Kushtetutës merr në konsideratë të gjitha kompetencat që i njihen Presidentit të Republikës në krerët e veçantë të Kushtetutës si dhe u shton atyre edhe kompetencat që parashikon neni 92.

Përcaktimi kushtetues se: *“Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.”*, i vendos ligjvënësit kufizimin kushtetues, që në respekt të pozicionit që ka ky organ (Presidenti i Republikës) të mos bëhet objekt i kompetencave shtesë, që dalin jashtë natyrës që Kushtetuta i njeh Presidentit shprehimisht.

Në të kundërt, çdo kompetencë e shtuar, jashtë ushtrimit të funksionit kushtetues që Presidenti ka dhe i njihet shprehimisht në Kushtetutë, nuk do të duhej të interpretohej ndryshe, veçse si një shpërdorim i rolit të tij (Presidentit), me pasoja kjo në perceptimin publik dhe institucional të Presidentit, si simbol i unitetit kombëtar.

Nga mënyra e formulimit të nenit 94 të Kushtetutës, kjo normë kushtetuese ka karakter ndalues dhe për vetë Presidentin e Republikës, në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues. Norma kushtetuese ka sanksionuar se Presidenti *“nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera...”*. Teknika e ndjekur nga kushtetutëberësi duket qartë se ka pasur për qëllim vendosjen e disa kufijve kushtetues për ushtrimin e kompetencave nga Presidenti i Republikës.

Dispozita kushtetuese e sipërcituar (pra neni 94) do të kishte një tjetër kuptim, në rast se do të ishte shkruar, në mënyrë pohuese, se “*Presidenti i Republikës mund të ushtrojë edhe kompetenca të tjera që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me Kushtetutën.*” Ky formulim do të ishte shumë i zgjeruar dhe do t’i jepte diskrecion Kuvendit për të parashikuar në ligje të tjera kompetenca të pakufizuara për Presidentin e Republikës.

Siç u theksua më lart, formulimi i përdorur nga Kushtetuta në nenin 94 është me karakter mohues. Pra, Presidenti i Republikës ndalohet (*është në formë mohuese*), të ushtrojë funksione tej atyre që nuk i njihen shprehimisht me Kushtetutë. Për më tepër që Kushtetuta ka synuar të kodifikojë në mënyrë shteruese të gjitha kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës.

Qëllimi i kushtetutëbërësit në formulimin e nenit 94 është vendosja e kufizimeve edhe ndaj Kuvendit që, në varësi të rrethanave të caktuara politike a konjunkturale, edhe pas hyrjes në fuqi të tekstit kushtetues, të mos zgjerojë pa kufij pushtetin e Presidentit të Republikës.

Ky është kuptimi ndalues që ka neni 94 i Kushtetutës. Prandaj, Kushtetuta ka sanksionuar shprehimisht kufizimin për pajisjen e Presidentit të Republikës me kompetenca të tjera “*përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë...*”.

Natyrisht në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese, Presidentit të Republikës mundet t’i jepen edhe kompetenca të tjera me ligje të veçanta. Megjithatë, që këto kompetenca të përmbushin kushtin ndalues dhe përjashtimor të parashikuar në nenin 94 të Kushtetutës, duhet që ato, jo vetëm të burojnë dhe të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me një kompetencë kushtetuese të tij, pra të njohur e shkruar brenda tekstit kushtetues, por edhe ta pajisin Presidentin e Republikës vetëm me një pushtet të mjaftueshëm për ushtrimin e funksionit kushtetues, për të cilin janë dhënë.

Në rast se Kuvendi do të synonte, me anë të një ligji të posaçëm, pajisjen e Presidentit të Republikës me kompetenca të tjera, Komisioni i Ligjeve vlerëson se atëherë do të duhej domosdoshmërisht të plotësonte tri kushte bazë:

Së pari: të respektojë ndalimin kushtetues, që nuk e lejon Presidentin e Republikës të ushtrojë kompetenca të tjera që burojnë nga ligjet e të cilat nuk i njihen shprehimisht nga Kushtetuta;

Së dyti: kompetenca që do t’i jepej Presidentit të Republikës, duhet të rrjedhë nga natyra kushtetuese e funksionit që ka ky organ, në raport me pushtetet e tjera kushtetuese;

Së treti: kompetenca ligjore që do t’i jepej Presidentit të Republikës, përderisa duhet të jetë kompetencë vetëm e natyrës kushtetuese dhe e lidhur drejtpërdrejt me organizimin dhe funksionimin e një organi kushtetues, nuk do të shmangej nga grupimi i kompetencave që listohen brenda një ligji organik (*që në të vërtetë mungon*) për këtë institucion (Presidentin e Republikës) të parashikuar shprehimisht nga Kushtetuta.

Bazuar sa më lart, Kuvendi, në ushtrim të funksionit të tij legjislativ, në çdo kohë, mund të ndryshojë, siç edhe e ka bërë tashmë, mënyrën ligjore të zgjedhjes dhe organet që mund të kenë të drejtë të zgjedhin Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKPKI.

Në këtë aspekt, Kuvendi gëzon një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien. Ky vlerësim bazohet edhe në argumentin e përdorur nga Gjykata Kushtetuese në

vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.22/2010 të saj ku parashtrahet se: *“Kuvendi është një nga organet e autoritetit të shtetit. Kompetencat e tij, dhe për pasojë sfera e veprimtarisë së tij, janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Brenda limiteve të parashikuara në Kushtetutë Kuvendi gëzon një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 20.05.2008). “*

Në miratimin e ndryshimeve në ligjin nr.9049/2003, Kuvendi i Shqipërisë ka mbajtur parasysh dhe ka vlerësuar së tepërmi funksionin e rëndësishëm ligjor që ILDKPKI ka dhe duhet të luajë në luftën kundër korrupsionit në radhët e administratës së lartë shtetërore, duke filluar nga Presidenti i Republikës dhe deri te zyrtari më i ulët.

Pritshmëritë që nuk janë përmbushur në nivelin e kërkuar dhe humbja gjithmonë e më shumë e besimit të opinionit publik tek organet e administratës shtetërore, për shkak të perceptimit të një korrupsioni endemik, ishin disa nga shtysat kryesore që Kuvendi i Shqipërisë erdhi në përfundimin se përzgjedhja e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI duhet të jetë pjesë e një reforme. Nga përmbajtja e dispozitave del e qartë se reformimi ka patur si qëllim kryesor rritjen e garancive ligjore që Inspektori i Përgjithshëm duhet të gëzojë gjatë kryerjes së detyrës dhe forcimin e kushteve dhe kriterëve ligjore profesionale për zgjedhjen e tij.

Vetë shumica e parashikuar në ligj për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm dhe për shkarkimin e tij, e ka vendosur këtë zyrtar të lartë të administratës shtetërore në një pozicion të veçantë, krahasuar edhe me procedurën e përdorur për zyrtarë të tjerë, funksionet e të cilëve gjejnë rregullim të posaçëm në Kushtetutë.

Gjithashtu, kujdes i posaçëm është treguar në mënjanimin e politizimit të procesit të paraqitjes dhe përzgjedhjes së kandidatave për Inspektor të Përgjithshëm të ILDKPKI, duke shmangur mundësinë e funksionarëve politikë për të konkuruar dhe t'u përzgjedhur në këtë detyrë të lartë shtetërore.

Në këtë aspekt, Kuvendi i Shqipërisë mbajti në konsideratë një situatë aspak pozitive dhe që binte ndesh me garancinë e mirëfunksionimit të një institucioni të pavarur, të krijuar me propozimin e fundit të Presidentit të Republikës për Inspektor të Përgjithshëm të ILDKPKI, ku një nga kandidatave në momentin e emërimit kryente një funksion të lartë politik, konkretisht detyrën e zv.ministrit, në qeverinë e maxhorancës së kaluar.

Hapja dhe transparenca e procesit përzgjedhës të Inspektorit të Përgjithshëm, sipas parashikimit të ri, duke i dhënë mundësi të gjithë subjekteve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për të konkuruar për detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, është tregues i vullnetit të Kuvendit, për të vendosur standarte të reja edhe në jetësimin e parimit të kufizimit të ndikimit politik në vendimarrjen për përzgjedhjen e funksionarëve të lartë shtetërore.

Me keqardhje dhe jo pa shqetësim, konstatojmë se, pavarësisht se shumica absolute e parashikuar për përzgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, është e njëjtë me atë që zgjidhet edhe Presidenti i Republikës, kjo risi në ligjin organik të funksionimit të ILDKPKI, nuk interpretohet nga ky institucion (Presidenti) si garanci e mjaftueshme për të siguruar pavarësinë nga politika të këtij institucioni.

Në këtë mënyrë, argumentet e sjella nga Presidenti i Republikës vënë në dyshim integritetin profesional dhe moral të subjekteve, që arrijnë të gëzojnë këtë shumicë zgjedhëse në funksione të larta shtetërore.

Anëtarët e opozitës në komision, në diskutimet e tyre (zv.kryetari i Komisionit), mbështetën motivet e parashtruara në dekretin e Presidentit për kthimin për rishqyrtim të ligjit, duke theksuar se ka nevojë që arsyet përkatëse të reflektohen në tekstin e ligjit, duke e ndryshuar atë.

Sipas përfaqësuesve të opozitës, interpretimi i dispozitës së nenit 92 dhe 94 të Kushtetutës nga ana e shumicës, është i gabuar dhe interpretohet prej tyre si një ndërhyrje me objektiv kufizimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës.

5.0 Përfundime

Përsa u parashtrua më lart, mbi propozimin e relatores, Komisioni i Ligjeve votoi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës dhe i propozon Kuvendit që në seancë plenare, bazuar në nenin 85, pika 2 të Kushtetutës, me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij, të votojë “kundër” dekretit nr.8566, datë 16.05.2014 të Presidentit të Republikës.

RELATORE

Vasilika Hysi



KRYETAR

Fatmir XHAFAJ

